



This project is co-funded
by the European Union



TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: **Trajner/e për dizenjimin e lojrave të tavolines**

Numri i kërkuar: **1(Një)**

Tipi i Kontratë: **Kontratë Shërbimi**

Kontraktuesi: **Organizata Përtej Barrierave**

Kohëzgjatja: **04-15 Qershor 2019**

Afati i fundit i aplikimit: **30 Maj 2019**

RRETH ORGANIZATËS

Përtej Barrierave është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse e cila është themeluar në Qershor të vitit 2004 nga një grup te rinjsh me aftësi të kufizuar dhe të rinj të tjerë që sot janë pjesë e bordit drejtues të organizatës.

Misioni i organizatës është: të promovojë mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë dhe vecanerisht për të rinj me disavantazhe sociale duke u ofruar atyre mbështetje për tu fuqizuar dhe marrë pjese aktive në jetën e komunitetit. Qëllimi ynë kryesor është të integrojmë të rinjtë me probleme sociale dhe disavantazhe në shoqëri.

Objektivat e organizates janë:

- ❖ Mbështetja e të rinjve me disavantazhe sociale për të zgjidhur në mënyrë të pavarur problemet që ata ndeshin në jetën e tyre të përditshme.
- ❖ Krijimin e mundësive për fuqizimin e individëve me më pak mundësi se të rinjtë e tjerë për të bërë zgjedhje të lira dhe për të arritur plotësimin profesional në jetë.
- ❖ Kryerja dhe nxitja e një sërë shërbimesh të adaptuar për nevojat e çdo të riu.
- ❖ Organizimi i të rinjve në grupe të ndryshme shoqërore duke ndihmuar për përmirsimin e zhvillimit të tyre në plan personal dhe social.
- ❖ Lëvizja drejt një modeli social për aftësinë e kufizuar.
- ❖ Ndërgjegjësimi i të rinjve me aftësi të kufizuar dhe shoqërisë për të drejtat e tyre
- ❖ Eliminimi i diskriminimit kundër individëve me aftësi të kufizuar





This project is co-funded
by the European Union



Nga Maji 2010 e në vazhdim, Përtej Barrierave është Pikë Kontakti për Shqipërinë për programin Erasmus+ Youth in Action të Komisionit Evropian. Në kuadër të kësaj, Përtej Barrierave ofron mbështetje dhe informim për të gjitha organizatat dhe individët e interesuar për të njohur programin Erasmus +YiA. E+ u jep mundësi shumë të rinjve të aftësohen dhe të mësojnë më shumë përmes trajnimeve me metodologjinë e edukimit jo-formal si dhe u jep një shans organizatave Shqiptare të realizojnë trajnime, seminare, shkëmbime rinore apo vullnetarizëm afat-gjatë dhe afat-shkurtër.

RRETH PROJEKTIT

Organizata Përtej Barrierave, është implementuese e projektit “**Fair Play- Creative Learning for Human Rights**” i cili financohet nga Bashkimi Europian dhe nën-grantohet nga organizata World Vision Shqipëria në kuadër të thirrjes “*Të rinjtë për të drejtat e njeriut në Shqipëri*” **Projekti është i fokusuar kryesisht në lojrat e tavolinës (board games) si një mjet kreativ, inovativ dhe edukativ për promovimin e të drejtave të njeriut mes të rinjve në Shqipëri. Projekti sjell elementin e lojërave edukuese nëpërmjet edukimit jo-formal të të rinjve.** Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është ngritja e ndërgjegjësimit të të rinjve dhe palëve të interesuara për rëndësinë e trajtimit të çështjes së të drejtave të njeriut nëpërmjet qasjeve inovative duke kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shoqërisë kohezive dhe aktive.

Objektivat specifikë të projektit janë:

- Të rritet niveli i njohjes nga të rinjtë në tema të tilla sic janë të drejtat e njeriut duke mënjanuar përjashtimin social dhe diskriminimin.
- Zhvillimi i kompetencave praktike në dizenjimin dhe aplikimin e lojërave të reja arsimore në edukimin për të drejtat e njeriut me të rinjtë.
- Zhvillimi i qëndrimeve pro-aktive për afrimin e të rinjve nga zonat me disavantazhe sociale dhe mundësia që ata do të kenë për të vepruar si implementues të këtyre lojërave në komunitetin e tyre.

Gjatë implementimit të projektit janë parashikuar disa aktivitete:

1. Kick of meeting (takimi paraprak)
2. Trajnimi për edukimin e të rinjve mbi të drejtat e njeriut
3. Laboratori i lojërave (Game lab)
4. Prodhimi i lojërave
5. Faza e testimit
6. Fair play day





This project is co-funded
by the European Union



OBJEKTIVAT E TOR

Lidhur me trajnimin e dytë, “Laboratori i Lojrave” organizata Përtej Barrierave po kërkon një Ekspert Trainer/e për të kryer trajnimin 3-ditor me 28 pjesëmarrës të grupmoshave 16-20 vjeç me tematikë kryesore “Krijimin e lojrave të tavolines” (Board Game)

Qëllimi kryesor i trajnimit të dytë “Game Lab” është rritja e njohurive, aftësive dhe kompetencave të pjesëmarrësve në lidhje me krijimin dhe dizenjimin e lojrave edukative, ndërgjegjësimin dhe përdorimin e tyre në nivel lokal dhe gjithashtu nëpër shkolla apo komunitetet ku ata bëjnë pjesë. Trajnimi do të bazohet në metodat e edukimit jo-formal.

Në projekt janë zgjedhur lojërat edukative si një mjet inovativ për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut mes të rinjve. Eksperti duhet të punojnë më të rinjtë ti njohë dhe udhëzojë ata me dizenjimin e lojrave arsimore dhe të përmirësojë aftësitë e tyre në prodhimin e lojrave për edukimin e të drejtave të njeriut.

Gjatë trajnimit do të trajtohen edhe çështje të tilla si: çfarë janë të drejtat e njeriut, si mund ti përdorim ato në jetën e përditshme, cilat janë instrumentat për mbrojtjen e tyre, përjashtimi social, ndalimi i diskriminimit, si dhe sfida të ndryshme globale por që japin një kontribut të madh në përfshirjen e të rinjve.

REZULTATET E PRITSHME TË TRAJNIMIT

- Rezultati konkret do të jetë krijimi i të paktën 2 (dy) lojrave që më vonë në aktivitetin e ardhshëm do të rishikohen më tej për tu elaboruar, për manualin e përdorimit të tyre, për gjuhën e përdorur, për qasjet miqësore me përdoruesit (të rinjtë) duke siguruar që perspektiva arsimore të jetë e qartë në këto lojra.
- 28 të rinj nga Tirana, Durrësi, Maliqi, Gramshi dhe Fushë- Kruja të trajnuar për dizenjimin e lojrave arsimore
- rritja e kompetencave të të rinjve në edukimin jo-formal dhe aktivizmin rinor
- rritja e kapacitetit të të rinjve për të përdorur këto lojra me të rinj të tjerë në komunitetet e tyre përkatëse dhe në shkollë.

PROFILI I EKSPERTIT TË KËRKUAR

- Eksperiencë në fushën e dizenjimit të lojrave dhe në edukimin jo-formal





This project is co-funded
by the European Union



- Eksperiencë e mëparshme në trajnime më të rinj për këtë temë
- Rezident/e në Shqipëri
- Aftësi të shkëlqyera gjuhësore në të folur dhe shkrim të gjuhës shqipe dhe angleze.
- Të jetë i/e aftë në përdorimin e mjeteve dixhitale
- Përvojë gjithëpërfshirëse në sigurimin e konsulencës
- I/e aftë në menaxhimin e kohës
- Të jetë i/e aftë të punojë me këtë grupmoshë

PËRGJEGJËSITË

Trajneri/a e kontraktuar duhet të:

- Propozojë dhe përshtasë skemën e përgjithshme të programit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të të rinjve në fushën e krijimit dhe dizenjimit të lojërave dhe të gemifikacionit.
- Të ketë bashkëpunim të ngushtë me koordinatorin dhe stafin e organizatës Përtej Barrierave dhe të jetë i/e hapur ndaj sugjerimeve
- Të kryejë trajnimin **3 (tre) ditë** me temat e lartpërmendura duke implementuar 4 sesione në ditë.
- Përgatit përshkrimin (outlines) e workshopeve të implementuara, timesheets, dhe t'ia dorëzojë kordinatorit.
- Përgatisë një raport vlerësimi për trajnimin përkatës.

MARRËVESHJA ME KONTRAKTUESIN:

1. Trajneri i përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë me organizatën kontraktuese Përtej Barrierave.
2. Pagesa e trajnerit do të kryhet sipas rregullave të aplikuara me kontratë shërbimi. Pagesa e trajnerit do të kryhet siç është parashikuar në kontratën e shërbimit të firmosur nga Kontraktuesi dhe i kontraktuari.
3. Shpenzimet e akomodimit, ushqimit dhe transportit të trajnerit/es do të mbulohen nga Kontraktuesi (Përtej Barrierave)





This project is co-funded
by the European Union



PERIUDHA E KONTRAKTIMIT

Periudha e kontraktimit është **12 ditë pune** nga data **04 Qershor 2019** deri në **15 Qershor 2019**, duke përfshirë përgatitjen, trajnimin 3 ditor dhe raportimin.

Procedurat e aplikimit:

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Curriculum Vitae e rifreskuar me të dhënat e fundit
- Letër interesi
- Evidenca ose shembuj nga eksperiencat e ngjashme të mëparshme
- Outline të Modulit që do të përdorë për trajnimin.
- Koston e konsulencës duke përfshirë taksat apo kosto shtesë të lidhura me transportin, akomodimin, ushqimin etj.

Proçesi i përzgjedhjes:

Propozimet e marra do të vlerësohen sipas kriteve të mëposhtme:

- Propozimi për teknik (eksperienca, moduli, CV-ja) (70%)
- Çmimi (30%)

KU TË APLIKONI

Dërgoni aplikimin tuaj me të gjithë dokumentat e kërkuara në një e-mail të vetëm në adresën: office@beyondbarriers.org deri më **30 Maj 2019, ora 12:00 AM**.

